Kronikë

# VIDEO/Kishte fshehur armë e municion luftarak në magazinë, arrestohet 61-vjeçari në Vlorë

*Një 61-vjeçar është arrestuar në Vlorë për armëmbajtje pa leje në kuadër të operacionit 'Sundimi i Ligjit'.*

HOROSKOPI

Redaksia
8 Dhjetor, 09:51 | Përditësimi: 8 Dhjetor, 10:14

Share

**VLORË**- Një 61-vjeçar është arrestuar në Vlorë për armëmbajtje pa leje në kuadër të operacionit 'Sundimi i Ligjit'. Viktor Aliaj kishte fshehur në magazinën e tij, 1 armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe 1 armë të ftohtë (thikë), të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale.

Nga verifikimet ka rezultuar se 61-vjeçari është babai i njërit prej shtetasve të arrestuar më parë nga Policia e Vlorës, në kuadër të operacionit policor të koduar "Obelisk", si rezultat i të cilit u parandalua një ngjarje e mundshme kriminale kundër personit, e cila do të kryhej me armë zjarri.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme.

LEXO EDHE:
**VIDEOLAJM/ Vlonjati 'sfidon' temperaturat e ulëta, not në muajin dhjetor**

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:13

## Në kërkim se kishte kanosur me armë një person, pranga 41-vjeçarit në Vlorë

Një tjetër i arrestuar ka rënë në pranga në Vlorë në kuadër të operacionit 'Sundimi i Ligjit'. Një 41-vjeçar i shpallur në kërkim nga policia është arrestuar, pasi në muajin korrik të vitit 2022, pas një konflikti të çastit, ka kanosur një 59-vjeçar, duke qëlluar në ajër, me armë zjarri pistoletë, të cilën e posedonte pa leje.

Pistoleta, të cilën 41-vjeçari Eurel Liçaj e posedonte pa leje, është gjetur sekuestruar nga Policia, pas ngjarjes.

> *"DVP Vlorë/Vlhet në pranga 1 shtetas i shpallur në kërkim, si rezultat i kontrolleve të ushtruara në zbatim të operacionit policor kombëtar të koduar "Sundimi i ligjit".*
>
> *Kanosi një shtetas, duke qëlluar në ajër, me armë zjarri pistoletë, kapet nga shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", 41-vjeçari i shpallur në kërkim. Pistoleta, të cilën 41-vjeçari e posedonte pa leje, është gjetur sekuestruar nga Policia, pas ngjarjes. Si rezultat i kontrolleve të mbështetura te informacionet e siguruara nga inteligjenca policore dhe të kryera në vijim të operacionit policor kombëtar të koduar "Sundimi i ligjit", shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja" të DVP Vlorë, në*
>
> *bashkëpunim me specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Vlorë, kapën dhe ndaluan shtetasin e shpallur në kërkim: Eurel Liçaj, 41 vjeç, banues në Vlorë.*
>
> *Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë i ka caktuar këtij shtetasi, masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit luftarak" dhe "Kanosja", pasi ky shtetas, në muajin korrik të vitit 2022, pas një konflikti të çastit, ka kanosur një 59-vjeçar, duke qëlluar në ajër, me armë zjarri pistoletë, të cilën e posedonte pa leje", njofton policia.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Sl.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Viktor Aliaj | Vlorë | armëmbajtje pa leje

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A duhet të marrë fund kaosi në kuvend?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

**Gjallesat në Sazan-Karaburun në rrezik nga turistët! Aqjencitë turistike shkelin kodin e sjelljes, ndotin plazhet**
Armand Xhelili
8 Dhjetor, 16:21

**D-Marin vjen në Shqipëri, rrjeti gjigant i menaxhimit të marinave marrëveshje bashkëpunimi me Vlora Marina**
7 Dhjetor, 17:53

**Tjetër aksident në rrugën Sarandë-Delvinë, mjeti del nga rruga dhe përmbyset**
7 Dhjetor, 07:32

**Vendimet e qeverisë/ Mbyllet kolegji universitar 'Pavarësia' në Vlorë**
6 Dhjetor, 21:58

**Skuadra turke e ndërtimit të anijeve turistike në Vlorë, inxhinieri: Pagesat janë të mira, fitoj më shumë se në Turqi**
Armand Xhelili
6 Dhjetor, 15:40

**VIDEO/ Në kërkim për kundërshtim të policisë, arrestohet 33 vjeçari në Vlorë (EMRI)**
6 Dhjetor, 14:08

**Aksident në rrugën Sarandë-Delvinë, automjeti del nga rruga dhe përmbyset! Plagoset drejtuesi 23 vjeçar**
5 Dhjetor, 10:33

**Komiteti i Bernës apel Shqipërisë për aeroportin e Vlorës: Të pezullohet ndërtimi në zonën e mbrojtur**
4 Dhjetor, 19:58

**Iu gjetën mbi 56 mijë euro të padeklaruara e 5 monedha ari, pranga 31-vjeçarit në Berat! Në hetim babai për armëmbajtje pa leje**
3 Dhjetor, 10:03

**Vlorë/ Ishte shpallur në kërkim për pengmarrje dhe plagosje, arrestohet 40-vjeçari**
3 Dhjetor, 09:54

**Vlorë, rruga merr emrin e Dëshmorit të Atdheut Elham Elezaj! Oficeri i RENEA-s ra në krye të detyrës në moshën 29 vjecare**
1 Dhjetor, 16:15

**Aksidentoi për vdekje me skaf 7-vjeçaren Jonada Avdia në 2022, ndahet dosja për ish-policin Arjan Tase! Gjyshi i të miturës: Gjykata të bëj drejtësi**
1 Dhjetor, 13:55

Lajmi i fundit

**Armando Brojën dhe 120 milionë euro, Chelsea 'sakrifikon' shqiptarin për ylin e Serie A**
9 Dhjetor, 21:42

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje